

VENDIM
Nr.974, datë 3.12.2010

PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE (FATKEQËSISË NATYRORE), NË ZONAT E PËRMBYTURA, SI PASOJË E RESHJEVE NË QARQET E Durrësit e të Lezhës

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, shkronja “c”, e 6, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), si pasojë e përkeqësimit të kushteve natyrore të motit e të reshjeve në zonat e përmbytura, në qarqet e Durrësit e të Lezhës.

2. Ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, i cili të kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;
- Ministrin e Shëndetësisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile;
- Drejtorin e Përgjithshëm të KESH-it.

3. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile të bashkërendojë punën me ministritë e linjës, me institucionet e prefektëve të qarqeve Durrës e Lezhë dhe me njësitë e qeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e emergjencës civile, për hartimin dhe zbatimin e planit të evakuimit të banorëve të zonave të prekura, për krijimin e kushteve të këtyre banorëve për jetesë, si dhe për marrjen e masave mbrojtëse e rehabilituese në infrastrukturën dhe mjedisin e prekur nga situata e krijuar.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Komitetit Ndërmintor i Emergjencave Civile, ministritë e linjës, prefektët e qarqeve Durrës e Lezhë, si dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha